

UNIVERSITETI I PRISHTINËS FAKULTETI I MJEKËSISË



**PRAKTIKA NDËRPROFESIONALE - KUJDESI DYTËSOR SHËNDETËSOR/
KUJDESI TRETËSOR SHËNDETËSOR - LogBook**

Mjekësi e Përgjithshme

Prishtinë, 2020

I. Rregullat e përgjithshme

- Praktika klinike në Kujdesin Dytësor Shëndetësor / Kujdesin Tretësor Shëndetësor mbahet për 2 javë (10 ditë pune) gjatë pushimit veror, nëpër spitalet rajonale më të afërta për studentë apo në klinikat e SHSKUK-.
- Gjatë kësaj kohe studenti duhet t'iu përshtatet dhe respektoj rregullat e punës të institucionit shëndetësor ku mbanë praktikën, përfshirë këtu:
 - Orari i punës
 - Rendi shtëpiak
 - Veshjen e uniformës
 - T'i ketë me vete çdoherë pajisjet e nevojshme për ekzaminim të pacientit (në varësi nga lëmia ku po ndjeket puna praktike)
- Praktika monitorohet nga një mentor në marrdhënie të rregullt pune në klinikën/spitalin/repartin përkatës, i caktuar nga drejtori i klinikës ose shefi i shërbimit.
- Në fund të praktikës, mentori klinik ose drejtori i klinikës/shefi i shërbimit është përgjegjës për t'a vlerësuar vijueshmërinë dhe mbarëvajtjen e kësaj pjese praktike mësimore. Më pas, shefi i Degës së Mjekësisë së Përgjithshme vërteton me nënshkrim se studenti ka përfunduar praktikën klinike në Kujdesin Dytësor/Tretësor Shëndetësor

Studenti pajiset me Logbook para fillimit të praktikës klinike gjegjësisht pak para përfundimit të semestrit veror (viti 4, semestri VIII) (shkarkohet ne web faqen e Fakultetit të Mjekësisë: adresa www.mjekesia.uni-pr.edu ose direkt ne linkun:

<https://mjekesia.uni-pr.edu/Ngjarje/LogBook-per-Praktiken-nderprofesionale.aspx>

II. Objektivat

- Njohja e parimeve themelore të kujdesit spitalor shëndetësor në nivel dytësor (spitalet rajonale) / tretësor (ShSKUK).
- Familjarizimi me karakteristikat sociale të komunitetit nga këndvështrimi i personelit shëndetësor
- Familjarizimi me faktorët mjedisor të rrezikut që favorizojnë sëmundjen, përkeqësimin dhe përmirësimin e saj
- Qasja direkte me pacientin duke asistuar/ praktikuar ekzaminimet e pacientit

- Kujdesi ndaj pacientit me sëmundje akute urgjente dhe emergjente
 - Kujdesi ndaj pacientit me sëmundje kronike
 - Kujdesi gjysemintenziv
 - Kujdesi paliativ ndaj pacientëve në gjendje terminale
- Familjarizimi me programet parandaluese dhe të promovimit të shëndetit
 - Familjarizohen me procesin e pranimit, hospitalizimit, përcjelljes, referimit, transferimit, lëshimit të pacientit nga spitali
 - Familjarizohen me vizita ambulatorie specialistike në shërbimet e poliklinikës së spitalit rajonal ose SHSKUK-së.

III. Rezultatet e pritura

Në fund të praktikës, studentët do jenë të njoftuar me:

- Organizimin e sistemit shëndetësor spitalor (kujdesit dytësor / tretësor shëndetësor)
- Organizimin e brendshëm të institucionit dhe raportin me insitucionet tjera të nivelit primar, sekondar / terciar.
- Qasjen ndaj pacientëve të hospitalizuar
- Zhvillimin e shkathtësive të komunikimit me pacientin përmes kontaktit fizik, mbështetjes, empatisë
- Detyrat e mjekut në raport me pacientin, detyrat e infermierit dhe personelit tjetër ndihmës
- Qasjen në dokumentacionin mjekësor
- Respektimin e kodit etik profesional, ruajtjejn e të dhënave personale dhe sekretit mjekësor
- Ndërtimin e marrdhënieve të frytshme dhe korrekte ndërkolegiale me personelin mjekësorë, infermieror, ndihmës e tekniko-administrativ.
- Hierarkinë e punës dhe detyrave në kujdesin shëndetësor spitalor
- Detyrat, përgjegjësitë dhe sfidat e mjekut klinikist në shërbimet e kujdesit shëndetësor dytësor dhe tretësor.
- Patologjitë më të shpeshta që trajtohen në këto nivele shërbimi shëndetësor.
- Metodat diagnostike dhe terapeutike që aplikohen.
- Rëndësinë e edukimit dhe promovimit shëndetësor në institucionet spitalore

IV. Orari i mbajtjes së praktikës ndërprofesionale – KDSH/KTSH

Orarin e mbajtjes së praktikës ndërprofesionale – KDSH/KTSH e përcakton vet institucioni nikoqir, pergjegjesit sipas rrethanave dhe fushëveprimit brenda 10 ditë pune. Gjatë 10 ditëve të realizimit të praktikës fokusi qëndron në njoftimin me:

- Rendin shtëpiak, detyrat e punës, stafin dhe ambientet e punës.
- Aspektet profesionale, teknike, ligjore dhe etike që lidhen me dokumentacionin mjekësor.
- Pjesëmarrja në vizitë me mentorin klinik ose shefin e njësisë, kryerja e detyrave të caktuara në repart nën mbikëqirjen e mentorit klinik / shefit të njësisë, komunikimi profesional me pacientët spitalor, ekzaminimi subjektiv (anamneza/heteroanamneza) dhe ekzaminimi objektiv (fizik) i tyre, përcjellja klinike spitalore; pjesëmarrja pasive dhe aktive në procedurë mjekësore diagnostike dhe terapeutike; Pjesëmarrja aktive dhe pasive në plotësimin e dokumentacionit mjekësor me rastin e pranimit, lëshimit dhe përcjelljes sistematike klinike/spitalore (plotësimi i të dhënave për dekursin klinik të pacientit).
- Pjesëmarrja pasive dhe aktive në procedurat intervente diagnostiko-terapeutike invazive dhe gjyseminvazive,
- Pjesëmarrja pasive dhe aktive në punën ambulatorë në poliklinikë specialiste.
- Pjesëmarrja pasive në takimet profesionale të disiplinës dhe ndërdisiplinare, në seminare dhe aktivitete tjera edukative klinike dhe shkencore.

V. Nënshkrimet

_____	_____
(emri mbiemri i studentit)	(nënshkrimi)
datë _____	

Vlerësimi i studentit nga personi përgjegjës në spital/klinikë*:

(emri mbiemri)

(nënshkrimi / faksimili)

datë _____

*duhet të potencohen datat e mbajtjes së praktikës në QMF

Aprovimi nga Shefi i Degës së Mjekësisë së Përgjithshme

(emri mbiemri)

(nënshkrimi / faksimili)

datë _____

SQARIM

Sipas PlanProgramit të studimeve të integruara të vitit 2016, studentët e Mjekësisë së Përgjithshme të vitit të 4^{të}, semestri i VIII^{të} janë të obliguar të kompletojnë “Praktika Ndërprofesionale – Kujdesi Dytësor Shëndetësor-KDSH/Kujdesi Tretësor Shëndetësor-KTSH”, me ç’rast grumbullohen ECTS e nevojshme.

Procedura që duhet të respektohet:

1. Praktika do kryhet gjatë muajve të verës (gusht-shtator) në spitalet rajonale më të afërta apo klinika te ShSKUK.
2. Në institucionin shëndetësor, duhet të paraqiteni tek personi përgjegjës i shërbimit
3. Përgjegjësitë dhe obligimet e studentit janë përshkruar në dokument
4. Studentët janë të obliguar të participojnë aktivisht në aktivitetet ditore të spitalit rajonal/klinikës.
5. Përfundimi i “Praktika Ndërprofesionale – KDSH/KTSH” nënshkruhet nga personi përgjegjës ne institucionin nikoqir.
6. “Praktika Ndërprofesionale – KDSH/KTSH” konsiderohet e përfunduar pas validimit gjegjësisht nënshkrimit nga ana e Shefit të Degës së Mjekësisë së Përgjithshme
7. Dokumenti i kompletuar dhe nënshkruar dorëzohet në Shërbimin e Studentëve ku edhe bëhet evidentimi i kompletimit të ECTS-ve.

Gjatë muajit qershor, studentët brenda 1 jave, në grupe të vogla do të takohen me Shefin e Degës së Mjekësisë së Përgjithshme për të detajuar mbarëvajtjen e punës praktike.